

OSHEE GROUP sh.a njofton mbi hapjen e vendit vakant **Specialist** pranë Departamentit të Teknologjisë së Informacionit / Drejtoria e Zhvillimit dhe Garantimit të Cilësisë / Sektori i Analizës të të Dhënave.

SPECIALIST

Detyrat dhe përgjegjësitë kryesore:

- Analizon dhe interpreton të dhënat e sistemeve në përdorim të kompanisë.
- Kryen testime periodike për të siguruar funksionimin e saktë të sistemeve.
- Krijon raporte mbi performancën e sistemeve dhe cilësinë e të dhënave.
- Identifikon problematikat dhe propozon zgjidhje të mundshme.
- Mirëmban sistemet e të dhënave.
- Detyra të tjera, të ngarkuara nga Eprori i drejtpërdrejtë.

Kualifikimet e kërkuara:

- Të ketë përfunduar studimet e larta në degët Informatikë, Informatikë Ekonomike, Inxhinieri Informatike.
- Të ketë njohuri të sistemeve të raportimit (Business Intelligence), databazave (MSSQL) dhe programimit me XML, Javascript, ose ETL frameworks.
- Të ketë aftësi të mira analitike dhe të jetë i aftë të grumbullojë, organizojë dhe raportojë saktë dhe qartë informacionin e gjeneruar nga analiza e të dhënave.
- Të ketë njohuri të gjuhës Angleze.
- Të ketë aftësi të mira komunikuese dhe të punës në grup.
- Të ketë eksperiencë pune mbi 1 vit.

Të gjithë kandidatët e interesuar janë të lutur të bëjnë aplikimin në websiten e OSHEE group, në portalin e punësimit.

Ju njoftojmë se vetëm kandidatët e përzgjedhur do të ftohen për intervistë.